

Arkivi i Shoqërisë Biblike dhe arkiva të tjera “protestante” si burim për historinë moderne shqiptare

The archives of the Bible Society and various “Protestant” archives as a source for modern Albanian history

Abstract: *The Protestant Christian tradition has a 200-year heritage in Albanian lands and was a force for the development of the written Albanian language at the dawn of the Albanian Awakening. The Protestant Movement has produced rich archival funds for modern Albanian history, because Protestant missionaries and Bible Society colporteurs wrote copiously, whether for personal and family reasons (such as journals and letters), or whether for work reasons (monthly or annual reports, official correspondence, etc.). In this article, several archives are presented, which contain documents related to the enterprises of this movement – such as those of the British and Foreign Bible Society, the American Board of Commissioners for Foreign Missions, etc. – with concrete details of how these sources can be accessed.*

“Shkruhen shumë libra, por nuk mbarohet kurrë kjo punë, dhe studimi i tepërt e lodh trupin.”¹ Kjo thënie nuk u shkrua në kohërat tona nga një filozof që njihte teknologjinë e shtypshkronjës apo fenomenin e kompanive tregtare të internetit, si “Amazon”. Përkundrazi, është shkruar rreth tre mijë vjet më parë, nga mbreti i tretë i Izraelit, Salomoni (rreth 970–931 para Krishtit), i cili u vlerësua si njeriu më i zgjuar i kohës së tij.² Ai ka shkruar shumicën e proverbeve të librit biblik *Fjalët e Urta* (në Dhiatën e Vjetër), si edhe librin *Predikuesi*. Thënia e Salomonit për shkrimin e librave qëndron edhe sot, kur mund të mbajmë në dorë pajisje elektronike me kapacitet për të ruajtur në formë digjitale jo vetëm libra, por biblioteka të tëra.

Kur përqendrohemi te shkrimi i historisë, vërejmë të njëjtin fenomen: “shkruhen shumë libra”. Mundësia teknike për botimin e shpejtë të librave, qoftë në formë fizike apo digjitale, është bekim edhe mallkim, në varësi të cilësisë së materialit të botuar. Pas rrëzimit të diktaturës, “rishkrimi i historisë” ka ngjallur debate të nxehta para publikut shqiptar, e jo pa të drejtë, sepse studimi dhe paraqitja e historisë është një detyrë aq e shenjtë

1 *Predikuesi* 12:12-14, Dhiata e Vjetër.

2 *1 Mbretërit* 4:29–34, Dhiata e Vjetër.

dhe e madhe, saqë meriton debat dhe bashkëpunimin e intelektualëve, jo vetëm për fusha të posaçme të albanologjisë (si p.sh. koha e Skënderbeut), por edhe për etikën dhe metodat që duhet të përdorim. Për qëllimet e këtij punimi lidhur me arkivat “protestante”, mjafton të përmendim, si aksiomë elementare, se rishkrimi i historisë nuk mund të kryhet kurrë si duhet nëse nuk zbulohen, studiohen e krahasohen burimet parësore. Ndonëse historiografia shqiptare ka vuajtur dikur nga mungesa e lirisë së plotë për të udhëtuar e për të zbuluar fonde me interes për shqiptarët në arkiva të huaj, sot dyert janë të hapura. Mbase mungojnë fonde për të mbështetur hulumtime; mbase mungojnë hulumtues të mjaftueshëm shqiptarë të përgatitur me aftësitë e duhura gjuhësore dhe teknike; e mbase mungon një strategji e mirëfilltë kombëtare për kryerjen e studimeve arkivore, por, së paku, nuk mungojnë burimet. Duke pasur parasysh sasinë e burimeve të pashfrytëzuara, ne jemi të mendimit që kontributi më i vlefshëm në këtë fazë të historiografisë shqiptare është gjetja e burimeve dhe botimi i tyre në original, mundësisht së bashku me përkthimet e tyre në gjuhën shqipe. Thënë ndryshe, historia duhet rilexuar para se të rishkruhet. Për këtë arsye, vlerësojmë tej mase nismat si kjo konferencë: “Drita e arkivave, dritë mbi arkivat”.

Në faqet që vijojnë, do të hedhim dritë mbi disa arkiva që mbajnë dokumente lidhur me veprimtarinë e Lëvizjes së Krishterë Protestante. Këto arkiva mbajnë një sasi befasuese të dhënash, jo me *mijëra* dokumente të pashfrytëzuara, por me *dhjetëra mijëra*. Si ndodhi që Lëvizja Protestante paska siguruar aq shumë burime për historinë moderne shqiptare?

– *Së pari*, sepse Lëvizja Protestante ka një trashëgimi mbi 200-vjeçare në trojet shqiptare, duke filluar në vitin 1816, kur misionari protestant skocez Robert Pinkertoni, përfaqësuesi i Shoqërisë Biblike, filloi veprimtarinë e tij për përkthimin e *Dhiatës së Re* në gjuhën shqipe. Pra, kemi të bëjmë me një besim tradicional shqiptar që erdhi si lëvizje misionare para Rilindjes Kombëtare e që përfshiu disa nga rilindësit më të shquar shqiptarë (si p.sh., Konstandin Kristoforidhin dhe familjen Qiriazi). Kjo lëvizje ka lulëzuar në Shqipëri gjatë shekullit të fundit të sundimit osman; ka ecur paralelisht me Rilindjen Kombëtare (madje ishte një forcë nxitëse e Rilindjes); ka vazhduar gjatë periudhës së turbullt të gjysmës së parë të shek. XX; ka mbijetuar gjatë diktaturës; dhe vazhdon e pandërprerë deri në ditët e sotme.

– *Së dyti*, sepse Lëvizja e Krishterë Protestante ka një kulturë leximi. Zemra e lëvizjes është parimi bazë i protestantizmit: *Sola Scriptura* (Shkrimi i Shenjtë është autoriteti i vetëm dhe përfundimtar për çështjet e besimit dhe duhet lexuar nga çdo njeri). Kështu, kur erdhën protestantët, pyetja e tyre e parë nuk ishte: “A ka krishterim në viset shqiptare?”, por ishte: “A ka një Bibël në gjuhën e këtij populli?”. Pastaj, kur *Dhiata e Re* u botua për herë të parë në gjuhën shqipe, më 1827, shqetësimi i protestantëve ka qenë së

pari lexueshmëria e saj nga shqiptarët e arsimuar, arsimimi i atyre që nuk mund të lexonin dhe botimi masiv dhe shpërndarja e Shkrimit të Shenjtë në çdo vend ku banonin shqiptarë. Kështu, kuptohet se veprimtaria e Lëvizjes Protestante ishte qenësisht e lidhur me përpjekjet për të lëvruar gjuhën shqipe si një gjuhë letrare.

– *Së treti*, Lëvizja Protestante ka prodhuar fonde të pasura arkivore për historinë shqiptare, sepse misionarët protestantë dhe librashitësit e Shoqërisë Biblike shkruanin shumë, qoftë për arsye familjare dhe personale (letra, ditarë etj.), qoftë për qëllime të punës (raporte mujore dhe vjetore, letërkëmbime zyrtare etj.). Zakonisht këto letra dhe raporte ruheshin jo vetëm nga institucionet përkatëse, por edhe nga shkruesit, të cilët përdorën “Letter Books” apo “Copybooks” (libra ose fletore me fleta të holla që shërbenin si dublikime, siç kemi sot “fletë dalje”, të cilët, kur hartohen, mbeten me një ose dy kopje identike poshtë origjinalit).

Gjithë këto shkrime dhe burime: letra, raporte, regjistra, tabela, piktura, kartolina, libra, artikuj për periodikë etj., duhen kuptuar në kontekstin e tyre parësor. Ato janë përshkrime të ecursisë së veprimtarisë së tyre të ungjillëzimit në çdo vend ku punonin. Kështu, misionarët dhe punonjësit e Shoqërisë Biblike shkruanin kryesisht për projektet e tyre për përkthimin dhe shpërndarjen e Biblës, kurse misionarët dhe punonjësit e Bordit Amerikan dhe të organizatave të ndryshme protestante shkruanin kryesisht për projektet e tyre për mbjelljen e kishave ungjillore dhe për themelimin e shkollave për djem e vajza. Kur misionarët apo librashitësit udhëtonin në vende të reja, ata shkruanin çka kishin parë dhe dëgjuar, me një sy drejt zgjerimit të veprimtarisë së tyre fetare në ato vende. Në këto shkrime, tema kryesore është gjendja fetare e popullit dhe pranimi (apo jo) i mesazhit të Ungjillit. Mirëpo, duhet kuptuar se në kontekstin e përhapjes së besimit protestant, ky shqetësim ishte i pandashëm nga shqetësimi për gjendjen arsimore të popujve, meqë përparimi i protestantizmit varej plotësisht nga aftësia e popullit për të lexuar Biblën në gjuhën amtare. Nuk po themi se shkrimet e misionarëve prekin vetëm tema fetare dhe arsimore. Përkundrazi, ato përmbajnë vështirime të rëndësishme për rrethanat shoqërore, politike, kulturore, ushtarake dhe ekonomike të kohës, sepse misionarët nuk ishin thjesht udhëtarë në Ballkan apo diplomatë të cilët shërbyen për një kohë të shkurtër, por ishin njerëz që banonin e punonin mes shqiptarëve për një kohë të gjatë. Prandaj, shkrimet e tyre pasqyrojnë një njohje të thellë të kontekstit në të cilin banonin. Vështirimet e tyre kanë një vlerë të madhe, sepse u shkruan në një kohë kur shqiptarët, në përgjithësi, nuk shkruanin dhe kur nuk vinin shumë të huaj në viset shqiptare. Për më tepër, duhet përmendur se Lëvizja Protestante nuk erdhi në Shqipëri me një ushtri sunduese, as nuk erdhi me synime politike, as duke favorizuar një popull mbi tjetrin, dhe, për këtë arsye, dokumentet

kanë një këndvështrim përgjithësisht neutral, diçka që është e rëndësishme në studimin e historisë.

Tani le të shqyrtojmë disa arkiva ku ruhen dokumente me interes për historinë moderne shqiptare, nga burime protestante.

Shoqëria Biblike britanike dhe për vendet e huaja

Fillojmë me Shoqërinë Biblike³, një shoqëri që nuk pranoi kurrë emërtimin “protestant”, ndonëse ishte themeluar nga protestantët, veçoi mbi baza teologjike protestante dhe shpeshherë hasi kundërshtime të forta nga Kisha Katolike Romake dhe Kisha Ortodokse Greke. Theksojmë përsëri se Shoqëria Biblike ka bërë një punë kolosale dhe sistematike për përkthimin, botimin dhe shpërndarjen e Biblës në dy dialekte të shqipes, duke filluar nga viti 1816, një kohë kur nuk kishte asnjë libër tjetër shqip në qarkullim, afro 100 vite para caktimit të alfabetit standard. Kështu, Shoqëria Biblike ofron dokumente jo vetëm *të rëndësishme* për studimin e lëvritit të gjuhës së shkruar shqipe, por edhe dokumente *të domosdoshme* për shkencën e gjuhësisë shqiptare. Që prej vitit 1804, biblioteka dhe arkivi i Shoqërisë Biblike ruhej në Londër, por në vitin 1985 zyrat qendrore të Shoqërisë u transferuan nga Londra në Swindon⁴. Mirëpo, biblioteka dhe arkivi i saj ishte aq i madh, saqë u transferua në Bibliotekën e Universitetit të Kembrixhit.⁵

Duhet të kujtojmë se arkivi i Shoqërisë Biblike është përdorur tashmë nga studiuesit shqiptarë dhe albanologë të huaj dhe disa prej tyre kanë ribotuar dokumente të rëndësishme prej arkivit. Kështu studiuesit janë të pajisur me shumë burime pa pasur nevojë për të shkuar në Kembrixh. Absolutisht nuk pohojmë se arkivi i Shoqërisë Biblike është shteruar, por pohojmë se kemi një “fillim të mbarë” dhe se asnjë hulumtues nuk duhet të harxhojë kohën dhe paranë e tij për hulumtime, pa u konsultuar me botime të botuara tashmë nga ky arkiv, që mund të gjenden sot në bibliotekat dhe libraritë e Shqipërisë, apo në “amazon.com”. Le të rreshtojmë disa burime që mund të shfrytëzohen tani dhe në të ardhmen nga fondet e Shoqërisë Biblike.

Raportet vjetore të Shoqërisë Biblike

Çdo vit Shoqëria Biblike ka botuar një raport për veprimtarinë e saj në gjithë botën. Raportet japin shifrat e botimeve, raportet e librashitësve, të dhënat për përkthyes dhe redaktorë, si dhe të dhëna për kulturën e vendeve të ndryshme, për ekonominë, infrastrukturën, politikën, doket dhe zakonet etj. Përgatitësit e raporteve vjetore synonin të përmbledhnin punën e vitit të mëparshëm, në mënyrë të ngjeshur, për të dhënë një vështrim të gjerë të

3 <https://www.biblesociety.org.uk/>

4 Bible Society, Stonehill Green, Westlea, Swindon, SN5 7DG.

5 Bible Society's Library, Cambridge University Library, West Road, Cambridge CB3 9DR

përparimit të Shoqërisë Biblike në botë. Në vitet e para pas themelimit të Shoqërisë Biblike, raportet e saj ishin të shkurta, por me kalimin e kohës, raportet arrinin deri në 700 faqe! Shqiptarët përmenden për herë të parë në raportin vjetor të vitit 1817, e pastaj u përmendën në thuajse çdo raport vijues, deri në vitin 1965 kur botimi i raporteve vjetore u mbyll. Prandaj, çdo studiues që ndërmerr hulumtime mbi Shoqërinë Biblike duhet të fillojë me këto raporte, sepse japin një tablo të gjerë kronologjike dhe një kuptim të qartë të natyrës së Shoqërisë dhe të veprimtarisë së saj në trojet shqiptare.

Ku mund të gjenden këto raporte vjetore? Vetëm disa prej tyre mund të gjenden të skanuara në internet⁶, por, sigurisht, librat fizikë gjenden të gjithë te Biblioteka dhe Arkivi i Shoqërisë Biblike në Kembrixh. Gjithashtu, në Londër, te “SOAS” (School of Oriental and African Studies, University of London), ruhet kolona e plotë e raporteve.⁷ Pikërisht te SOAS-i kam kaluar disa javë, duke shfletuar çdo faqe nga 160 raportet, e duke skanuar çdo rast ku përmenden shqiptarët apo tema të ndryshme lidhur me kontekstin shqiptar. Pas një pune disavjeçare për transkriptimin e tekstit original, sot, për herë të parë, mund të lajmërojmë botimin e një libri që sapo ka dalë nga shtypi: *Albania and the Albanians in the Annual Reports of the British and Foreign Bible Society, 1805–1955 (Shqipëria dhe shqiptarët në raportet vjetore të Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja)*.⁸ Ky libër prej 450-faqesh, me një indeks prej 400 hyrjesh, ende nuk është përkthyer në shqip, por, së paku, origjinali anglisht mund të shfrytëzohet menjëherë nga studiuesit shqiptarë dhe nga albanologë të huaj si një studim bazë përgatitor para se të kryhen hulumtime të mëtejshme. Patjetër, disa të dhëna nga këto raporte vjetore janë përkthyer dhe shfrytëzuar kohë më përpara, nga studiues të ndryshëm, si Xh. Lloshi, Memli Krasniqi etj., por tani disponojmë, brenda një vëllimi *gjithçka* sa është shkruar për shqiptarët në këto 160 raporte vjetore.

Raporte apo periodikë të tjerë të Shoqërisë Biblike

Shoqëria Biblike ka botuar, gjithashtu, raporte mujore, të ngjashme me raportet vjetore, jo për gjithë botën, por duke theksuar çdo muaj disa nga vendet ku punonte Shoqëria, me artikuj dhe fotografi. Këto raporte u botuan nga viti 1817–1971, me titullin *The Monthly Reporter of the British & Foreign Bible Society* (për vitet 1817–1904) e pastaj me titullin

6 Si për shembull te <https://catalog.hathitrust.org/Record/000544111>, <https://books.google.com/> dhe <https://archive.org/>.

7 <https://www.soas.ac.uk/library/>

8 Hosaflook, David (ed.). *Albania and the Albanians in the Annual Reports of the British and Foreign Bible Society, 1805–1955*. Tirana: Institute for Albanian and Protestant Studies, 2017.

The Bible in the World (për vitet 1905–1971). Disa prej këtyre vëllimeve janë shfrytëzuar nga studiues shqiptarë, por deri tani nuk jemi në dijeni për ndonjë studiues i cili ka shfletuar çdo faqe të secilit vëllim të këtyre raporteve mujore, për të gjetur të dhëna për shqiptarët. Por kjo punë duhet kryer, siç është bërë për raportet vjetore. Megjithatë, jemi të sigurt se shqiptarët përmenden, së paku, në raportet mujore të këtyre viteve: 1886–1868, 1881, 1897–1899, 1901, 1905–1913, 1919, 1921 dhe 1925. Në disa prej këtyre vëllimeve, shqiptarët jo vetëm përmenden, por ka artikuj të veçantë për Shqipërinë, si p.sh.:

1. 1866: shkrime nga ditari i Aleksandër Davidsonit për udhëtimin e tij në Shqipërinë Jugore
2. 1867–1868: përshkrimi i udhëtimit të Aleksandër Tomsonit në Shqipëri
3. 1881: raporti i zhdukjes së një librashitësi në Shqipëri (Sosnovski)
4. 1907: raporti me titull “A Tour in Macedonia and Bulgaria by the Rev. T. R. Hodgson” (“Një udhëtim në Maqedoni dhe Bullgari nga rev. T. R. Hoxhson”)
5. 1909: “A Tour in Albania” (“Një udhëtim në Shqipëri”, nga T. R. Hodgson)
6. 1911 (shtator): “Through South Albania” (“Përmes Shqipërisë Jugore”, nga T. R. Hodgson)
7. 1911 (tetor): “The Development of Albania” (“Zhvillimi i Shqipërisë”, nga Lumo Skëndo)
8. 1912 (korrik): “Albania and the Bible Society” (“Shqipëria dhe Shoqëria Biblike”, nga Lumo Skëndo)
9. 1913 (dhjetor): “The Albanian Bible” (“Bibla shqipe”, nga T. R. Hodgson)
10. 1919 (nëntor): “Albania and the Bible Society” (“Shqipëria dhe Shoqëria Biblike”, nga T. R. Hodgson)
11. 1921 (mars): Përshkrimi i udhëtimit të Thanas Sinës në Shqipëri
12. 1925 (nëntor): “Round about unto Illyricum” (“Gjer në Iliri”, nga W. J. Wiseman).

Shoqëria Biblike botoi edhe dy periodikë të tjerë. I pari ishte një botim mujor apo dymujor, që synonte lexues të rinj dhe u botua në vitet 1869–1963, me tre tituj të ndryshëm: *Gleanings for the Young* (1869–1898), *The Bible Society Gleanings* (1899–1922) dhe *For Every Land* (1923–1963). Në këtë periodik u botua një artikull nga T. R. Hodgson-i më 1898 me titullin “How Boys and Girls Buy the Bible in Albania” (“Si e blejnë Biblën djem dhe vajza në Shqipëri”). Periodiku i dytë ishte *A Popular Illustrated Report of the*

British and Foreign Bible Society (Një raport popullor i ilustruar i Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja), një botim vjetor me artikuj dhe fotografi, secili numër me një titull të veçantë⁹, botuar në vitet 1900–1963. Edhe për këta periodikë, duhet kryer një studim sistematik për secilin numër, për të gjetur çdo të dhënë për Shqipërinë dhe për shqiptarët.

Letërkëmbime dhe dorëshkrime të Shoqërisë Biblike

Raportet vjetore dhe mujore janë të domosdoshme për të kuptuar rrjedhën e përgjithshme të veprimtarisë së Shoqërisë Biblike në trojet shqiptare, por studimi i thellë i kësaj veprimtarie kërkon hulumtimin e burimeve prej të cilave janë hartuar raportet, sidomos letërkëmbimet dhe dorëshkrimet që gjenden në arkivin e Shoqërisë Biblike. Edhe këtu jemi me fat, sepse në Shqipëri kemi fotokopje të shumë dokumenteve të arkivit të Shoqërisë Biblike. Në vitin 1972, gjuhëtari i shquar prof.dr. Xhevat Lloshi bëri hulumtime në këtë arkiv (kur ndodhej në Londër), hulumtime të cilat kanë shërbyer si bazë për dhjetëra studime shkencore nga ana e tij në dobi të gjuhësisë shqiptare, ballkanike e botërore.¹⁰ Pas kthimit të tij nga Londra, prof. Lloshi ka dorëzuar, pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Tiranë, fotokopjet e qindra letërkëmbimeve me interes për historinë dhe gjuhësinë shqiptare, të cilat ruhen edhe sot. Letërkëmbimet mbulojnë një kohë të gjatë, vitet 1819–1946, por shumica e tyre kanë të bëjnë me K. Kristoforidhin, Aleksandër Tomsonin dhe përkthimet shqipe.

Ndërkohë, në vitin 1994, studiuesi amerikano-anglez dr. John Quanrud (Kuanrud), autori i biografisë për Gjasim Qiriazin, ka zbuluar në Stamboll një mori letërkëmbimesh nga “Shtëpia e Biblës”, e cila ishte qendra për Shoqërinë Biblike dhe për Bordin Amerikan në Perandorinë Osmane.¹¹ Shumica e tyre ishin letra nga përfaqësuesi kryesor i Shoqërisë Biblike për Perandorinë Osmane, Aleksandër Tomsoni (“Outward Correspondence”), ose përshkrime të letrave që të tjerët i kishin dërguar Tomsonit (“Inward Correspondence”). Si Xh. Lloshi në Londër, Kuanrudi në Stamboll i ka fotokopjuar këto dokumente, i ka shfrytëzuar për librin e tij për Gjasimin

9 Po japim dy tituj si shembuj. Vini re se nëntitulli është i njëjtë: *There is a River: a Popular Illustrated Report of the British and Foreign Bible Society for the year 1905–1906; The Word among the Nations: a Popular Illustrated Report of the British and Foreign Bible Society for the year 1908–1909*.

10 Disa nga botimet të rëndësishme të prof. Xh. Lloshit lidhur me veprimtarinë e Shoqërisë Biblike janë: *Përkthimi i V. Meksit dhe redaktimi i G. Gjirakastritit: 1819–1827* (Tiranë: Onufri, 2012); *Pesë libra të Dhiatës së Vjetër në versionin toskërisht, 1882–1884* (Parathënia) (Tiranë: Shoqëria Biblike Ndërkonfesionale e Shqipërisë, 2017); *Psalmet gegërisht dhe toskërisht* (Parathënia) (Tiranë: Shoqëria Biblike Ndërkonfesionale e Shqipërisë, 2015).

11 Më vonë, Shoqëria Biblike në Stamboll i ka dërguar shumicën e origjinaleve për në arkivin kryesor të Shoqërisë Biblike në Kembrixh.

dhe ia ka kaluar prof. Xhevat Lloshit, Shoqërisë Biblike Ndërkonfesionale dhe Institutit për Studime Shqiptare dhe Protestante. Prof. Lloshi synon të përkthejë shqip sa më shumë nga këto letërkëmbime, dhe sapo e ka nxjerrë vëllimin e parë të tyre, për vitet 1815–1883 – një vepër kolosale me 650 faqe.¹²

Me gjithë punën që është kryer deri tani, përsëri mbeten shumë dokumente të pazbuluara dhe të pashfrytëzuara, që ruhen në Arkivin e Shoqërisë Biblike, meqë ai mban letërkëmbime nga së paku 4830 korrespondentë, në 1130 vëllime dhe në 1170 kuti. Përtej kësaj, fondet e Arkivit janë gjithnjë në rritje, sepse aty ka dokumente ende të paidentifikuara dhe sepse vazhdojnë të transferohen në Kembrixh burime nga shoqëri biblike rajonale, anembanë botës. Si shembull i dokumenteve që duhen zbuluar, mund të përmendim rastin e librashitësve shëtitës, që ishin shqiptarë, gjermanë, anglezë, skocezë, bullgarë, maqedonas, grekë etj. Kemi identifikuar, vetëm për vitet 1860–1908, emrat e 55 librashitësve të Shoqërisë Biblike, që udhëtonin vazhdimisht nëpër qytete, qyteza dhe fshatra shqiptare në tokat që tani gjenden në Shqipëri, Greqi, Maqedoni dhe Kosovë, duke shpërndarë Shkrimet e Shenjta në gjuhën shqipe, veprimtari që rriti ndjenjën kulturore, letrare, fetare dhe arsimore jo vetëm në qendrat kryesore shqiptare jashtë atdheut, si p.sh. në Bukuresht apo në Stamboll, por deri në zonat e thella të Shqipërisë. Këta librashitës shkruanin raporte vazhdimisht dhe shkrimet e tyre mund të na japin të dhëna të rralla dhe të çmuara për shqiptarët dhe për kushtet e tyre në çdo cep të Shqipërisë. Mirëpo, deri tani janë zbuluar vetëm disa prej raporteve të tyre.

Bordi Amerikan i komisionerëve për misionet në vendet e huaja

Bordi Amerikan (American Board of Commissioners for Foreign Missions, apo ABCFM) ka qenë e para shoqëri misionare protestante e Amerikës dhe ka luajtur rol të rëndësishëm për ngritjen e Lëvizjes Protestante Ungjillore Shqiptare në fund të shek. XIX. Në vitin 1819 u dërguan misionarët e parë amerikanë në Perandorinë Osmane dhe, prej asaj kohe, veprimtaria e Bordit u zgjerua deri në momentin që misionarët e tij u takuan me shqiptarë, fillimisht në udhëtimet e tyre e pastaj kur u themelua një stacion i Bordit në Manastir, më 1873. Bordi Amerikan u mor me arsimimin e shqiptarëve në Bullgari, Maqedoni dhe Shqipëri, u përfshi në themelimin e Mësonjëtores së Vashave në Korçë më 1891, dhe drejtoi ceremoninë e shugurimit të Gjerasim Qiriazit si predikuesi i parë protestant shqiptar. Në vitin 1908 Phineas dhe Violet Kennedy, dhe Charles dhe Carrie Erickson u caktuan si misionarë të Bordit Amerikan për Shqipërinë.

12 Lloshi, Xhevat (me Xhon Kuanrud dhe David Hosaflook). *Thesaret për gjuhën shqipe të Shoqërisë Biblike (1815–1883)*. Tiranë: Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante, 2017.

Raportet vjetore të Bordit Amerikan

Çdo vit ABCFM-ja mbante një mbledhje vjetore në një qytet të rëndësishëm të Amerikës për të diskutuar përparimin e tyre në mbarë botën. Pas mbledhjes ata shtypnin një raport vjetor me informacion të përzgjedhur nga letërkëmbime të vitit të kaluar, siç bëri Shoqëria Biblike. Për herë të parë shqiptarët përmenden në këto raporte kalimthi më 1827. Sërish përmenden më 1852 dhe më pas më 1859. Nga 1872–1924 përmenden pothuaj në çdo raport vijues. Ndryshe nga raportet vjetore të BFBS-së, të gjitha raportet e ABCFM-së mund të shkarkohen nëpërmjet internetit, nga uebfaqja e Bibliotekës së Universitetit Jejl (Yale).¹³ Si për raportet e Shoqërisë Biblike, sivjet kemi ribotuar të gjitha të dhënat për Shqipërinë dhe shqiptarët nga raportet vjetore të ABCFM-së, jo vetëm në origjinalin anglisht¹⁴, por edhe në një përkthim shqip.¹⁵

Revista “The Missionary Herald”

Në vitin 1821, ABCFM-ja nisi botimin e një reviste mujore me titullin *The Missionary Herald*, e cila përshkruante zakone, historinë, aktivitete ekonomike dhe tipare gjeografike të vendeve të ndryshme, së bashku me raportet e ndikimit të Ungjillit në ato vende. Këto revista gjenden në arkivin e Bordit, tek “American Research Institute in Turkey” në Stamboll. Shqipëria u përmend shpesh në këto revista, deri në vitin 1922 kur ABCFM-ja u detyrua të mbyllte misionin e vet në Shqipëri. Ndonëse nuk janë mbledhur e botuar të gjithë artikujt për Shqipërinë dhe shqiptarët – e kjo punë duhet kryer – mund të themi me siguri se shqiptarët përmenden dhjetëra herë në këto revista dhe, madje, ka disa artikuj të veçantë për Shqipërinë.

Letërkëmbime dhe dorëshkrime të Bordit Amerikan

Ka dy arkiva kryesore lidhur me Bordin Amerikan, me të dhëna për historinë shqiptare. I pari dhe më i madhi ndodhet në Bibliotekën Houghton, në Universitetin e Harvardit, në Cambridge, Massachusetts (afër Bostonit)¹⁶, dhe mban 384 metra linearë me burime për veprimtarinë e Bordit në botë. Një pjesë e konsiderueshme e letërkëmbimeve të arkivit u filmua rreth vitit 1980 dhe sot ruhet në 858 bobina, të cilët janë të

13 <http://web.library.yale.edu/divinity/day-missions-collection-annual-reports-listing>

14 Hosaflook, David (red.). *Albania and the Albanians in the Annual Reports of the American Board of Commissioners for Foreign Missions, 1820–1924*. Tirana: Institute for Albanian and Protestant Studies, 2017.

15 Hosaflook, David (red.) (përktheu Xhevat Lloshi). *Shqipëria dhe shqiptarët në raportet vjetore të Bordit Amerikan të Komisionerëve për Misionet në Vendet e Huaja, 1820–1924*. Tiranë: Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante, 2017.

16 <http://oasis.lib.harvard.edu/oasis/deliver/~hou01467>.

indeksuara dhe mund të blihen të kopjuara.¹⁷ Universiteti Bilkent në Turqi e ka çuar këtë punë edhe më tej, duke siguruar një indeks për thuajse çdo letër nga bobinat që kanë lidhje me tokat e Perandorisë Osmane.¹⁸

Arkivi i dytë lidhur me Bordin Amerikan është Biblioteka dhe Arkivi i Bordit Amerikan në Stamboll, i cili në vitin 2010 u transferua tek American Research Institute in Turkey (ARIT), po në Stamboll.¹⁹ ARIT-i ka filluar projektin për digjitalizimin dhe katalogimin e arkivit, dhe frytet e para të punës së ARIT-it mund të përdoren, që tani, në internet.²⁰

Arkiva të ndryshme lidhur me lëvizjen protestante shqiptare

Shoqëria e Broshurave Fetare (“Religious Tract Society” – RTS) botoi disa vëllime në gjuhën shqipe: shtatë broshura fetare, botuar rreth vitit 1825, përkthyer nga Grigor Gjirokastriti (këto nuk janë zbuluar ende); abetare në gegërisht e në toskërisht; dhe libra fetarë për fëmijë (përkthyer nga Konstandin Kristoforidhi). Arkivi i RTS-së tani ruhet me arkivin e “United Society for Christian Literature”, në Universitetin e Londrës.²¹ Për fat të keq, një pjesë e madhe e këtij arkivi u shkatërrua kur gjermanët bombarduan Londrën. Gjithsesi, Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante (ISShP) ka filluar procesin e hulumtimit në këtë arkiv, një arkiv që tani ruan 370 vëllime dhe 40 kuti me dokumente. Çdo studiues që kërkon të ndërmarrë hulumtime në këtë arkiv, këshillohet të lidhet më parë me ISShP-në për bashkërenditjen e përpjekjeve.

Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante u themelua më 2014 me qëllim “për të nxitur zbulimin e historisë dhe mendimit shqiptar e protestant”.²² Brenda disa vitesh ai ka ndërtuar një bibliotekë me rreth 900 hyrje dhe me mijëra dokumente të ndryshme. Përveç dhurimeve nga individë të ndryshëm, ky instituti ka trashëguar edhe dy fonde arkivore:

– *Fondi i Misionit Ungjillor Shqiptar* (Albanian Evangelical Mission), i cili ka, kryesisht, libra, letërkëmbime dhe fotografi nga fundi i shek. XX; dhe

– *Fondi i misionarit amerikan Edvin Xhejks* (Edwin Jacques), i cili ka shërbyer në Korçë në vitet 1932–1940. Në këtë fond, ka libra, revista, fjalorë, kartolina, fotografi, raporte, broshura fetare, himne, Bibla dhe letërkëmbime nga njerëz të shquar, si misionarët amerikanë Phineas Kennedy dhe Charles Erickson, si dhe nga Sevasti dhe Parashqevia Qiriazhi. Edhe pse Edvin Xhejksi u detyrua të largohej nga Shqipëria më 1940, ai grumbulloi dokumente gjatë gjithë jetës së tij, të cilët e pasurojnë këtë

17 <http://microformguides.gale.com/Data/Download/3041000R.pdf> dhe

18 http://history.bilkent.edu.tr/index_files/ABCFM.htm

19 <http://www.dlir.org/arit-istanbul.html>

20 <http://www.dlir.org/arit-digital-library.html>

21 <https://www.soas.ac.uk/library/archives/collections/a-z/u/>

22 <http://www.instituti.org>

burim. Ky fond është në procesin përgatitor për digjitalizim, që të botohet në internet.²³

Ka edhe fonde të tjera arkivore për historinë moderne shqiptare, nga institucione protestante (ose me natyrë protestante) që kanë punuar mes shqiptarëve, si: Shoqëria Misionare e Londrës (London Missionary Society), Shoqëria Misionare e Kishës (Church Missionary Society), Shoqëria në Ndihmë të Misioneve në Turqi (Turkish Missions' Aid Society), Shoqëria Biblike Joniane (Ionian Bible Society), Unioni Misionar Baptist Amerikan (American Baptist Missionary Union), Shoqëria Misionare e Kishës Metodiste-Episkopale (Missionary Society of the Methodist-Episcopalian Church), Bordi i Gruas për Misionet (Woman's Board of Missions) etj. Gjithë këto arkiva do të hedhin dritë jo vetëm për një fushë pak të njohur të historisë së Shqipërisë, siç është Lëvizja Protestante, por edhe mbi dhjetëra aspekte të jetës dhe kulturës shqiptare.

23 Disa kartolina janë botuar në arkivin elektronik www.archive.org (kërko: "Edwin Jacques" apo "Institute for Albanian and Protestant Studies").